



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 28.05.2020, nxjerr këtë:

### VENDIM

- I. **Znj. Shukrije Shala**, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Klinë, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës" PDK", duke e zëvendësuar anëtarën e Kuvendit Komunal znj. Shqipnora Dauti.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së që ky vendim t'i komunikohet znj. Shukrije Shala, dhe të ndërmerrën vendprime procedurale për zbatimin e tij.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorzuar në KQZ më datën 19.05.2020, Nr. 489/2020, për zëvendësimin e anëtarës së Kuvendit Komunal znj. Shqipnora Dauti, pas dorheqjes së saj të përvokueshme nga pozita e anëtarës së Kuvendit, për arsye personale.

Pas shqyrtimit të kërkesës në fjalë dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidatja e radhës në listën e rirenditur, e cila është znj. Shukrije Shala, e cila ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidate e radhës, nga i njëjti subjekt politik dhe e njëjta gjini, dhe me numër më të madhë të votave, sipas rezultateve të certifikuara të zgjedhjeve lokale të vitit 2017. Andaj, pas plotësimit të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I dhe II të këtij vendimi.

- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 28.05.2020

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

  
Valdete Daka